Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

## Shtojca 8

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;*
- c. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*
- ç. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për pajisjet e ofruara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 9001** (të vlefshme) të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

*Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve /mallrave /shërbimeve që do të marrë përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes.*

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit .
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

### 2.3. Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose broshurë me të dhënat teknike për pajisjet e ofruara, të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Në katalog, të markohet në menyre të qartë dhe të dallueshme secila nga pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar, si dhe të markohen specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT.
  3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për origjinën e pajisjeve të ofruara.
  4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi i pajisjeve ose nga distributori i autorizuar që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së pajisjeve, për një periudhë jo më pak se 2 vjet.
  5. Operatori ekonomik duhet të paraqes Deklaratë EC të konformitetit nga prodhuesi i pajisjeve.
  6. Operatori ekonomik duhet të paraqes një deklaratë që merr përsipër të kryej riparimin e pajisjeve pranë një servisi të autorizuar nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar ose pranë një servisi që ka marrëveshje bashkëpunimi apo marrëdhënie kontraktuale me servisin/serviset e autorizuar nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar.
  7. Operatori ekonomik duhet të deklarojë të paktën **1 (një)** punonjës të punësuar në stafin e tij, i cili do të kryejë trajnimin e stafit të autoritetit kontraktor për pajisjet laboratorike sipas kërkesave të specifikimeve teknike në Shtojcën 10.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 9

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### Specifikimet Teknike për të gjitha produktet (Aparat per Kontrollin e Matesave te Ujit, Aparat Spektrometri, Aparat Densimetri, Peshore Elektronike).

#### I. Aparat per Kontrollin e Matesave te Ujit ( Sasia : 1 Cope )

1. Matës uji portabël për verifikimin e një matësi uji
2. Modeli I matesit :Portabël për verifikimin me precision të lartë të një matësi uji
3. Diapazoni/shtrirja 0.03 m<sup>3</sup>/h - 6.0 m<sup>3</sup>/h
4. Kapaciteti për testimin e një matësi uji: Diapazoni I rrjedhës 0.030 m<sup>3</sup>/h – 6 m<sup>3</sup>/h
5. Saktësia ≤ 1% ±
 

|             |                                                   |
|-------------|---------------------------------------------------|
|             | 0.030 m <sup>3</sup> /h – 0.06 m <sup>3</sup> /h  |
| i. ≤ 0.4%   | 0.060 m <sup>3</sup> /h – 0.250 m <sup>3</sup> /h |
| ii. ≤ 0.25% | 0.250 m <sup>3</sup> /h – 6.0 m <sup>3</sup> /h   |
6. Lloji I matësit elektromagnetik
7. Presioni max 10 bar
8. Ekran LCD ALPHA NUMERIK, minimumi 4 linja, 20 simbole
9. Tastiera min 10 fotografi dhe 5 butona kontrolli
10. Frekuenca e futur dhe impulse – 2kHz maksimumi
11. Saktësia/ intervali i temperaturës - 1C
12. Ndërfaqe – RS 232 për matjen/llogaritjen e të dhënave (opsion)
13. Bateria – 12V/7.5Ah minimumi
14. Kohëzgjatja e baterisë – minimum 12 orë
15. Përshtatësi I ofrimtoit të energjisë – 90 V deri në 260 V AC/15 V DC 4.0 A
16. Dimensione – 400 deri në 550 \* 200-350 \* 300-500 mm minimumi
17. Peshë – Maksimumi 12 kg
18. Temperatura maksimale e ujit të matur : 55 C
19. Temperatura maksimale e ajrit – maksimumi: 40 C
20. Ruajtja dhe kushtet e transportit – temperatura e ajrit 0 °C deri në 50 °C /pa vibrime
21. Deklarate garancie per produktin per nje periudhe minimalisht 2 vjecare
22. Katalog i produktit ne gjuhen shqipe per specifikimet teknike
23. Perfshirja e trajnimit te stafit (minimalisht 12 persona) per perdorimin e pajisjes nga ana e subjektit

#### II. Aparat Spektrometri ( Sasia : 1 Cope )

1. Fusha e Elementeve testues: Analiza te njehershme,(njekoheshme) te elementeve nga Na (Natriumi) tek U (Urani)
2. Dedektor: Portabël, analizues me rreze X
3. Rezulocioni I Dedektorit; max 139 ± 5eV

4. Sistemi i akselirimit; 50KV/100  $\mu$ A tub mini i integruar me rreze X
5. Objekti e Testimit; Te Ngurta, Te Lengshem ose Pluhur
6. Filter i Drejte dhe Optik; kalim automatik
7. Sistem Video; kamera HD
8. Arritshmeria; max 1ppm- 99,99%
9. Procesori dhe Memoria; CPU; 667MHz, memoria 256M, me zgjerim ruajtje kapaciteti deri ne 32G, konfigurimi standard 2G.
10. Koha e testimit; 1 – 60 sek maksimumi
11. WiFi dhe Bluetooth; te perfshire ne sistem
12. Kohezgjatje e Baterise; kapaciteti maksimal 7800mAh per bateri te karikueshme litiumi, min 8 ore perdorimim i pandërprere.
13. Ekran; gjysem-transparent gjysem reflektiv me prekje
14. System fryrje; presion Konstant sstem me mbushje Helium
15. Perpunimi i te dhenave; proces dixhital i shpejte me frekuence perpunimi min 80m
16. Lageshtia e Ambientit;  $\leq 90\%$
17. Temperatura e Ambientit – 20 °C - +50°C
18. Deklarate garancie per produktin per nje periudhe minimalisht 2 vjecare
19. Katalog i produktit ne gjuhen shqipe per specifikimet teknike
20. Perfshirja e trajnimit te stafit (minimalisht 5 persona) per perdorimin e pajisjes nga ana e subjektit

### III. Aparat Densimetri ( Sasia : 1 Cope )

|                                                    |                                                  |
|----------------------------------------------------|--------------------------------------------------|
| 1. Diapazoni i Matjes                              | 0 g/cm <sup>3</sup> – 3 g/cm <sup>3</sup>        |
| 2. Temperatura e Matjes                            | 0 deri 40 C                                      |
| 3. Saktesia                                        | 0.0001g/cm <sup>3</sup> - 0.001g/cm <sup>3</sup> |
| 4. Perseritshmeria                                 | 0.0001 - 0.0005                                  |
| 5. Zberthimi, Depertimi, Shperberje, Rezolucioni   | 0.0001g/cm <sup>3</sup> - 0.001g/cm <sup>3</sup> |
| 6. Diapazoni Temperatures per Mostren              | -10 °C + 50°C                                    |
| 7. Zberthimi, Depertimi, Shperberja e Temperatures | 0.10 deri në 0.125C                              |
| 8. Vellimi minimal i Mostres                       | 1 ml -2 mL                                       |
| 9. Saktesia e Temperatures                         | $\pm 0.1C$ deri në $\pm 0.20C$                   |
| 10. Diapazoni i Temperatures se Ambientit          | - 10°C – 50 °C                                   |
| 11. Balancimi, Kompensimi i Temperatures           | Automatik                                        |
| 12. Metodot                                        | 30 - 50                                          |
| 13. Kapaciteti i ruajtjes se Rezultateve           | 1000-1500                                        |
| 14. Gjuhet<br>etj                                  | Anglisht, Italisht, Gjermanisht                  |
| 15. Ekran<br>ngjyra                                | minimumi 2.4 siperfaqe me                        |
| 16. Perdorimi ekranit/lidhja                       | butona dhe leve                                  |
| 17. Lidhjet                                        | USB-A USB-C                                      |

- |                                                                             |                                                                      |
|-----------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|
| 18. Siguria                                                                 | me kod(password)                                                     |
| 19. Energjia                                                                | Bateri me jone Litiumi, Bateri e<br>karikueshme dhe e zevendesueshme |
| 20. Pesha                                                                   | maksimumi 355 gr                                                     |
| 21. Numri materialit                                                        | 30330857                                                             |
| 22. Deklarate garancie per produktin per nje periudhe minimalisht 2 vjecare |                                                                      |
| 23. Katalog i produktit ne gjuhen shqipe per specifikimet teknike           |                                                                      |

#### IV. Peshore Elektronike ( Sasia : 3 Cope )

Karakteristikat e Produktit (Precizioni/ Kapaciteti maksimal  $\leq 30\,000$  gr

- |                                                                             |                                                                 |
|-----------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|
| 1. Lloji i Stabilizimit                                                     | Kapacitet I larte stabilizues, koha jo më<br>shumë se 5 seconda |
| 2. Ekran/monitori                                                           | Ekran me prekje(komanda nga ekran)                              |
| 3. Regullimi/pershtatja/Regjistrimi                                         | E brendshme, isoCAL                                             |
| 4. Kapaciteti I peshimit                                                    | 0 - 30 000 gr                                                   |
| 5. Lexueshmëria (d)                                                         | 10mg - 100 mg                                                   |
| 6. Funksionimi/operimi                                                      | Komandimi ne ekran, per funksionet kryesore<br>me celesa        |
| 7. Nderfaqe opsionale                                                       | • RS-232, / transferim te dhenash                               |
| 8. Transporti                                                               | Te siguroje mbrojtje gjate transportimit                        |
| 9. Perdorimi                                                                | Laborator/Prodhim                                               |
| 10. Deklarate garancie per produktin per nje periudhe minimalisht 2 vjecare |                                                                 |
| 11. Katalog i produktit ne gjuhen shqipe per specifikimet teknike           |                                                                 |

**Shënim : Në momentin e dorëzimit të mallit pranë autoritetit kontraktor, të gjitha pajisjet laboratorike duhet të jenë të shoqëruara me dokumentacionin e mëposhtëm:**

- Deklaratë Konformiteti nga prodhuesi
- Markim CE
- Autorizim Prodhuesi
- Katalog ku të jenë të përfshira specifikimet teknike
- Garancia për produktin për një periudhë minimale prej 2 vjetësh (Afati i garancisë minimalisht 2 vjet sipas ligjit 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar

Sqarojmë se dokumentacioni i kërkuar shoqëron produktin dhe është specifik sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, dhe VKM Nr 770/2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentat matëse “, për disa ndryshime në vendimin nr 1351, datë 03.10.2018 të KM, “Për miratimin e rregullores për kërkesat metrologjike për instrumentat matës ligjërish të kontrolluara” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”



**- Specifikimet teknike për pajisjet :**

**a- Matës uji**

**b- Aparat densimetri**

**c- Peshore elektronike**

Janë hartuar në përputhje me Legjislacionin në fuqi për përdorimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar nga ana e inspektimit metrologjik, pjesë e ISHMT, bazuar në Ligjin Nr.9875/2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 770/2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, për disa ndryshime në vendimin nr.1351/2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”, dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuar, Vendimit Nr. 1351/2008 “Per miratimin e rregullores per parapaketimet”. Në këtë akte është parashikuar përdorimi i këtyre instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar nga ISHMT, gabimet minimale të lejuara, kushtet e tjera teknike si presioni minimal dhe maksimal i rrjedhës së ujit, etj, sipas specifikimeve teknike qe jane dhene me lart.

Në zbatim të legjislacionit për metrologjinë dhe konkretisht Ligjit Nr.9875/2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 770/2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, për disa ndryshime në vendimin nr.1351/2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”, dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuar, Vendimit Nr. 1352/2008 “Per miratimin e rregullores per parapaketimet”, ISHMT i del si detyrim për kryerjen e protokollmatjeve për produktet e paketuara dhe jo të paketuara, për të cilat është kërkuar blerja e produktit peshore sipas specifikimeve sa më sipër. Matja e vëllimeve që është detyrim i sektorit metrologjik kërkon përdorimin e aparatit densimetër, i cili i referohet specifikimeve sipas legjislacionit në fuqi sa më sipër.

Kontrolli metrologjik i matësave të ujit është një detyrë e inspektimit metrologjik referuar legjislacionit për metrologjinë sipas të cilit janë parashikuar edhe specifikimet për këtë pajisje

**- Specifikimet teknike për sa i përket pajisjes:**

**a- Spektrometër**

- Janë bazuar në detyrimet e ISHMT për kryerjen e testeve për përmbajtjen e metaleve të rënda dhe të elementëve të tjerë të ndaluar në produktet joushqimore sipas përcaktimeve të Ligjit 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, i ndryshuar, Ligjit 10480/2011 ‘Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore’, i ndryshuar, VKM 262/2013 “Për sigurinë e Lodrave”, dhe VKM 1058/2015 “Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi dhe markimi perkates”.

**Afati maksimal i levrimit per kitet laboratorike do te jete 90 dite.**

## Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

| Nr. | Emërtimi            | Njësia | Sasia |
|-----|---------------------|--------|-------|
| 1   | Aparat Spektrometri | copë   | 1     |
| 2   | Aparat Densimetri   | copë   | 1     |
| 3   | Mates Uji           | copë   | 1     |
| 4   | Peshore Elektronike | copë   | 3     |

**Afati i lëvrimit:** 90 (nëntëdhjetë) ditë nga lidhja e kontratës

## Shtojca 11

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

### PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

| Mall:<br>Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër |                     |                                  |
|-------------------------------------------------------------|---------------------|----------------------------------|
| Kontrata<br>Nr.                                             | Titulli i Kontratës | Përshkrim i shkurtër i kontratës |
| 01                                                          |                     |                                  |
| 02                                                          |                     |                                  |
| 03                                                          |                     |                                  |
| ...                                                         |                     |                                  |

## Shtojca 12

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< Emri >

## Shtojca 13

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[\_\_\_\_\_]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit: \_\_\_\_\_

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

|                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

|                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

|                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/ Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 15**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME**



## **Mallrat –Kërkesë për propozim**

### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim

të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktuesi” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha

dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

## **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashikojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

#### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.

8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

#### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.

9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.

9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.

9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

#### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo

dispozitë përkatëse të kontratës.

- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

#### **Neni 11: Ambalazhimi**

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

#### **Neni 12: Testimet dhe Inspektimet**

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
